



## KOMUNA E NOVOBËRDËS

*Komuna e Novobërdës, 23.02.2026*

### **Thirrje publike për ofertën e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e mbrojtjes së qytetarëve në situata emergjente.**

1. **Komuna e Novobërdës** fton të gjitha organizatat joqeveritare që janë të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e mbrojtjes së qytetarëve në situata emergjente, të aplikojnë për mbështetje financiare për realizimin e projekteve në fushën e mbrojtjes së qytetarëve në situata emergjente.
2. Në përputhje me këtë thirrje publike, OJQ-të mund të aplikojnë me projekte/programe për fushat prioritare sipas sa vijon:
  1. Zbatimi i mbrojtjes nga zjarri, shpëtimi i njerëzve dhe pronës, parandalimi dhe shuarja e aksidenteve të tjera teknike dhe teknologjike dhe fatkeqësive natyrore.
  2. Realizimi i projekteve dhe programeve në këtë fushë që janë me interes publik.
3. Një OJQ mund të paraqesë vetëm një projekt, i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të parashikuara në pikën 2 të kësaj Thirrjeje Publike.
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **160,000.00 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) euro.**
5. Afati për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga data e publikimit të Thirrjes Publike, pra data e fillimit është data **23.02.2025 dhe përfundon më 13.03.2025.**
6. Të drejtën e aplikimit e kanë OJQ-të, të cilat janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të Republikës së Kosovës, me seli në territorin e komunës së Novobërdës dhe komunave përreth të rajonit të Gjilanit (Lindje), të cilat veprojnë dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të Thirrjes Publike.

OJQ që aplikon duhet të dorëzojë dëshmi se gjatë vitit të fundit është marrë me aktivitete për mbrojtjen e qytetarëve që përjetojnë dhunë në familje, kopje të licencës, si dhe nëse ka qenë përfituese e fondeve nga Komuna e Novobërdës, duhet të dëshmojë se i ka arsyetuar ato përmes raporteve financiare.

Pas nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të dorëzojë dëshmi se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim për vepra penale, si dhe dëshmi se OJQ ka zgjidhur të gjitha çështjet e hapura lidhur me pagesën e kontributeve dhe taksave që mund të kenë qenë të papaguara.

7. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë, i cili së bashku me Udhëzuesin për Aplikantët gjendet në faqen e internetit:

<https://kk.rks-gov.net/novoberde/sr/>

Dokumentacioni i plotë duhet të dorëzohet me postë ose personalisht në adresën:

Komuna e Novobërdës  
Bostane p.n.  
16000 Novobërdë

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi i tyre, kontraktimi, burimet, koha dhe mënyra e paraqitjes së ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari i zbatimit të thirrjes janë të paraqitura në mënyrë të detajuar në Udhëzuesin për Aplikantët.

Për mbështetje financiare do të shqyrtohen vetëm projektet që janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar dhe që i përmbushin plotësisht kushtet e kësaj thirrjeje publike.

8. Të gjitha pyetjet lidhur me këtë thirrje publike mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën:  
[info.novoberde@rks-gov.net](mailto:info.novoberde@rks-gov.net)

Predsednik opštine



Te dorzohen:  
Zyres se kryetarit,  
Drejtoris per buxhet dhe financa,  
Drejtoris se Administrates,  
Arhivi.